

# Pyetje dhe përgjigje për regjistrimin digjital të hyrjes në Gjermani (DEA)

Më poshtë gjeni pyetjet dhe përgjigjet më të rëndësishme.

- Të përgjithshme
- Zonë rreziku
- Përjashtime nga detyrimi për regjistrim
- Synimi dhe mënyra e funksionimit të DEA
- Në rast problemesh teknike
- Kontrollat

## Të përgjithshme

### Çfarë është regjistrimi digjital i hyrjes në Gjermani (DEA)?

Për të lehtësuar punën e Zyrave të Shëndetit Publik dhe për të mbështetur proceset ekzistuese të monitorimit të karantinës, qeveria gjermane ka krijuar Regjistrimin Digjital të Hyrjes (DEA), i cili zëvendëson regjistrimin e mëparshëm të bazuar në letër dhe përpunimin e të dhënave të udhëtarëve me të ashtuquajturat karta dalje. Regjistrimi Digjital i Hyrjes duhet të plotësohet **nga të gjithë udhëtarët që hyjnë në Gjermani**, të cilët kanë qëndruar në një zonë rreziku ose në një zonë me rrezik veçanërisht të lartë (zonë me incidencë të lartë ose zonë me variante të virusit) **dhjetë ditët e fundit para hyrjes në Gjermani** dhe që nuk përfshihen në asnjë nga përjashtimet e përcaktuara. Aplikacionin mund ta gjeni në adresën <https://www.einreiseanmeldung.de>.

### Çfarë përcakton rregullorja e hyrjes e koronavirusit?

Rregullorja e hyrjes në Gjermani gjatë pandemisë së koronavirusit rregullon, si plotësim i rregullave të karantinës të landeve federale, në mënyrë të njësuar regjistrimin, detyrimet për teste dhe detyrimet e paraqitjes së dëshmisë përkatëse. Kjo përfshin një detyrim të përgjithshëm për testim dhe paraqitje të dëshmisë përkatëse për ata që hyjnë në Gjermani me transport ajror, si dhe detyrime të posaçme për testim dhe paraqitje të dëshmisë në kuadër të një udhëtimi hyrës në Republikën Federale të Gjermanisë pas një qëndrimi në një zonë rreziku jashtë Gjermanisë. Ajo përcakton edhe detyrimet e sipërmarrjeve të transportit dhe të operatorëve të rrjetit celular.

Përcaktimet e rregullores së deritashme të detyrimit për test të 4 nëntorit 2020 (Gazeta Zyrtare e Qeverisë Federale, Pjesa e Përgjithshme, 06.11.2020 V1), e direktivave për udhëtimet e 5 nëntorit 2020 (Gazeta Zyrtare e Qeverisë Federale, Pjesa e Përgjithshme, 06.11.2020 B5) dhe Rregullores së Mbrojtjes nga koronavirusi, për t'u mbrojtur nga rreziku i infektimit që shoqëron hyrjen në Gjermani lidhur me mutacionet e reja të koronavirusit (Gazeta Zyrtare e Qeverisë Federale, Pjesa e Përgjithshme, 21 Dhjetor, 2020 V4) janë transferuar në këtë rregullore të re të qeverisë federale gjermane dhe janë zhvilluar më tej.

## Zonat e rrezikut

### Çfarë është një zonë rreziku?

Një zonë rreziku është një **zonë jashtë Republikës Federale të Gjermanisë**, për të cilën Ministria Federale e Shëndetësisë, pas konsultimit me Ministrinë Federale të Punëve të Jashtme dhe me Ministrinë Federale të Punëve të Brendshme, të Ndërtimit dhe Zhvillimit të Territorit kanë konstatuar një **rrezik të shtuar të infektimit** me një sëmundje të caktuar të rrezikshme ngjitëse, p.sh. infektim me koronavirusin SARS-CoV-2. Instituti Robert Koch publikon në internet në adresën <https://www.rki.de/risikogebiete> një **listë të zonave të rrezikut**, e cila përditësohet rregullisht.

### Çfarë është një zonë me rrezik veçanërisht të lartë?

Në një zonë jashtë Republikës Federale të Gjermanisë ekziston një rrezik veçanërisht i lartë, kur atje ka një incidencë veçanërisht të lartë të përhapjes së koronavirusit SARS-CoV-2 (**zonë me incidencë të lartë**) ose kur variante të caktuara të koronavirusit SARS-CoV-2 janë shfaqur atje në mënyrë të përhapur (**zonë e varianteve të virusit**).

**Zona me incidencë të lartë** mund të jenë zona me numër veçanërisht të madh të infektimeve, p.sh. disa herë më të larta se incidenca mesatare 7-ditore për 100.000 banorë në Gjermani, por të paktën me një incidencë 7-ditore prej 200.

**Zona të varianteve të virusit** mund të jenë zona në të cilat një variant i virusit (mutacioni) i koronavirusit SARS-CoV-2 është shfaqur në mënyrë të përhapur, i cili nuk është shfaqur në mënyrë të përhapur njëkohësisht edhe në Gjermani dhe për të cilin mund të supozohet se paraqet një rrezik të veçantë. Rreziqe të tilla të veçanta, për shembull, mund të rezultojnë nga përcjellja e dyshuar ose e dëshmuar më e lehtë ose nga veti të tjera që përshpejtojnë përhapjen e infektimit, që e bëjnë më të rëndë sëmundjen ose kundër së cilës është dobësuar efekti i një imuniteti të arritur përmes vaksinimit ose infektimit në të kaluarën.

Ministria Federale e Shëndetësisë konstaton pas konsultimit me Ministrinë Federale të Punëve të Jashtme dhe me Ministrinë Federale të Punëve të Brendshme, të Ndërtimit dhe Zhvillimit të Territorit se në cilat vende ekziston aktualisht një rrezik veçanërisht i lartë i infektimit me koronavirusin SARS-CoV-2. **Se cilat zona janë klasifikuar aktualisht** si zona me incidencë të lartë dhe variante të virusit, këtë mund ta mësoni nga **lista** në vijim në faqen e internetit: <https://www.rki.de/risikogebiete>.

## **Si e dalloni nëse po hyni nga një zonë rreziku, një zonë me incidencë të lartë ose nga një zonë e varianteve të virusit?**

Instituti Robert Koch publikon në internet në adresën: <https://www.rki.de/risikogebiete> një listë që përditësohet në vazhdimësi të zonave të rrezikut, të zonave me incidencë të lartë dhe zonave të varianteve të virusit.

Klasifikimi si zonë rreziku, zonë me incidencë të lartë ose zonë e variantit të virusit bëhet vetëm kur mbaron dita e parë pas publikimit të konstatimit në faqen e lartpërmendur në internet. Lista e Institutit Robert Koch tregon emrin e landit federal, përkatësisht rajonin e landit federal në kllapa, **që prej kur konsiderohet zona një zonë rreziku, zonë me incidencë të lartë ose zonë me variant të virusit**. Në fund të faqes do të gjeni një përmbledhje të zonave që kanë qenë zona me rrezik në një moment të caktuar në 10 ditët e fundit, por që NUK janë të tilla aktualisht.

## **Sa herë përditësohen klasifikimet e zonave të udhëtimit?**

Qeveria Federale gjermane verifikon vazhdimisht, se a ka zona që mund të klasifikohen si zona rreziku. Prandaj, ndryshimet mund të bëhen edhe papritur, veçanërisht mund të zgjerohet lista e zonave të rrezikut.

## **Pse bëhet dallim midis zonave të rrezikut dhe zonave me rrezik veçanërisht të lartë?**

Ky dallim bëhet për arsyen se rreziku veçanërisht i lartë për t'u infektuar në zona të tilla mund të luftohet me rregulla më të rrepta të hyrjes në Gjermani. Duhet të bëhet dallim midis zonave me një rrezik të shtuar (**zona rreziku**) dhe zonave me një rrezik veçanërisht të lartë për t'u infektuar me koronavirusin SARS-CoV-2. Në një zonë jashtë Republikës Federale të Gjermanisë ekziston një rrezik veçanërisht i lartë, kur ka një incidencë veçanërisht të lartë të përhapjes së koronavirusit SARS-CoV-2 (**zonë me incidencë të lartë**) ose kur atje janë shfaqur në mënyrë të përhapur variante të caktuara të koronavirusit SARS-CoV-2 (**zona të varianteve të virusit**). Rregullat më të rrepta shërbejnë për të kufizuar edhe më tej infektimin me koronavirus SARS-CoV 2 dhe për të shmangur përhapjen e shpejtë të varianteve të reja të virusit.

## Përrjashtime nga detyrimi për regjistrim

### A ka përrjashtime nga detyrimi për të plotësuar formularin e regjistrimit digjital të hyrjes?

Po. Megjithatë, këto varen nga lloji i zonës së rrezikut në të cilën keni qenë në 10 ditët e fundit para hyrjes suaj në Republikën Federale të Gjermanisë. Faktori vendimtar nuk është vendi prej të cilit jeni nisur, por vendet ku keni qëndruar në 10 ditët e fundit.

Përrjashtimet për zonat me incidencë të lartë janë konceptuar më me rreptësi, pasi ekziston një rrezik veçanërisht i lartë i infektimit me koronavirusin SARS-CoV-2, krahasuar me zonat e rrezikut.

**Kini kujdes: nuk ka përrjashtime nga detyrimi për regjistrim për zonat e varianteve të virusit. Kjo do të thotë që të gjithë udhëtarët që kanë qëndruar në një zonë të tillë në 10 ditët e fundit duhet të plotësojnë një DEA.**

Në **zonat e rrezikut**, nuk duhet të plotësojnë një DEA para se të hyjnë në Gjermani këto grupe personash:

1. Personat, të cilët kanë udhëtuar vetëm tranzit në një zonë rreziku dhe nuk kanë ndaluar përkohësisht atje,
2. Personat që hyjnë vetëm për tranzit në Republikën Federale të Gjermanisë dhe që largohen nga Republika Federale e Gjermanisë në rrugën më të shpejtë të mundur për ta përfunduar tranzitin,
3. Personat që kanë qëndruar në një zonë rreziku më pak se 24 orë në kuadër të qarkullimit ndërkufitar ose që hyjnë në Republikën Federale të Gjermanisë për një kohëzgjatje maksimale prej 24 orësh,
4. Personat që hyjnë për arsye profesionale në Republikën Federale të Gjermanisë, duke respektuar si duhet konceptet e mbrojtjes dhe të higjenës, për të transportuar persona, mallra ose produkte përtej kufijve nëpërmjet rrugëve, hekurudhave, anijeve ose avionëve.
5. Personat që kthehen në Gjermani si pjesë e delegacioneve zyrtare përmes terminalit qeveritar të Aeroportit Brandenburg/Berlin ose përmes Aeroportit Köln/Bon, të cilët kanë qëndruar më pak se 72 orë në një zonë rreziku.

Në **zonat e incidencës së lartë**, nuk duhet të plotësojnë një DEA para se të hyjnë në Gjermani këto grupe personash:

1. Personat, të cilët kanë udhëtuar vetëm tranzit në një zonë me incidencë të lartë dhe nuk kanë ndaluar përkohësisht atje,

2. Personat që hyjnë vetëm për tranzit në Republikën Federale të Gjermanisë dhe që largohen nga Republika Federale e Gjermanisë në rrugën më të shpejtë të mundur për ta përfunduar tranzitin,
3. Personat që kanë qëndruar në një zonë me incidencë të lartë më pak se 24 orë në kuadër të qarkullimit ndërkufitar ose që hyjnë në Republikën Federale të Gjermanisë për një kohëzgjatje maksimale prej 24 orësh,
4. Personat që kthehen në Gjermani si pjesë e delegacioneve zyrtare përmes terminalit qeveritar të Aeroportit Berlin/Brandenburg ose përmes Aeroportit Köln/Bon, të cilët kanë qëndruar më pak se 72 orë në një zonë me incidencë të lartë.

Udhëtarët e përditshëm vajtje-ardhje, që vijnë nga një zonë e varianteve të virusit, dhe të cilët i nënshtrohen në këtë mënyrë detyrimit për t'u regjistruar, si dhe udhëtarët e rregullt ndërkufitarë vajtje-ardhje dhe punonjësit ndërkufitarë duhet ta plotësojnë regjistrimin digjital të hyrjes në Gjermani vetëm një herë në javë. Dëshmia e regjistrimit digjital të hyrjes mbetet e vlefshme për këtë periudhë kohore.

Në këtë rast, si vend banimi në Gjermani duhet të shënohet adresa e vendit të punës, qendrës së trajnimit ose e një vendi tjetër, me të cilin ekziston një lidhje në konstelacionin konkret. Përveç kësaj, në aplikacion duhet të zgjidhet edhe një përjashtim përkatës dhe kur është e nevojshme, mund të bëhen specifikime të tjera në fushën bosh të tekstit.

### **Çfarë duhet të mbaj parasysh kur udhëtoj me avion dhe bëj një ndalesë të ndërmjetme?**

Pasagjerët e tranzitit me një ndalesë të ndërmjetme në një aeroport kanë detyrimin të regjistrohen, kur ky aeroport ndodhet në një zonë rreziku.

### **Rregullorja model e karantinës e zbatuar nga landet federale parashikon disa përjashtime nga karantina. Pse nuk përjashtohen të gjitha këto përjashtime edhe nga detyrimi për të bërë një regjistrim digjital të hyrjes në Gjermani?**

Qëllimi i regjistrimit digjital të hyrjes është t'u sigurojë Zyrrave të Shëndetit Publik me shpejtësi dhe pa ndërlikime informacionet që u nevojiten, për të monitoruar respektimin e detyrimit të karantinës, të përcaktuar nga ligji i një landi federal. Këtu bën pjesë edhe verifikimi, nëse personat që pretendojnë përjashtime të caktuara nga detyrimi i karantinës kanë me të vërtetë të drejtë ta bëjnë këtë. Për shembull, disa nga këto përjashtime lidhen me paraqitjen e një rezultati negativ të testit. Falë të dhënave të transmetuara si pjesë e regjistrimit digjital të hyrjes, Zyrrat e Shëndetit Publik janë në gjendje të kërkojnë dëshmi të tilla nga udhëtarët që hyjnë.

Për këtë qëllim, përjashtimet janë të kufizuara në konstelacione shumë të përcaktuara. Për shembull, konstelacionet në të cilat ose transportuesi ose autoriteti i ngarkuar me kontrollin policor të trafikut ndërkufitar mund ta kuptojnë shpejt se një karantinë në Gjermani nuk paraqitet si opsion (p.sh. për udhëtarët që kalojnë tranzit) ose në të cilat nuk duket e mundur deklarimi i një adresë vendbanimi (p.sh për udhëtarët e përditshëm vajtje-ardhje).

## **Synimi dhe mënyra e funksionimit të DEA**

### **Cili është synimi i regjistrimit digjital të hyrjes në Gjermani?**

Digjitalizimi i regjistrimeve të hyrjeve në Gjermani nga zonat e rrezikut, që më parë bëhej me kartat e daljes, lehtëson punën e Zyrave të Shëndetit Publik. Ato mësojnë me shpejtësi dhe në mënyrë të besueshme se kush vjen nga një zonë rreziku në zonën e tyre të kompetencës dhe duhet të kalojë në karantinë. Kjo është një mënyrë më e mirë për të shmangur krijimin e vatrave të reja të infeksionit për shkak të të ardhurve.

### **Si funksionon regjistrimi digjital i hyrjes në Gjermani? Kush mund t'i shikojë të dhënat e mia?**

Për t'u regjistruar, udhëtarët që hyjnë në Gjermani vizitojnë faqen e internetit <https://www.einreiseanmeldung.de> dhe japin të dhëna për vendqëndrimet e tyre në 10 ditët e fundit. Kur një nga këto vende bën pjesë në zonat e rrezikut, udhëtarit i kërkohet të japë të dhënat personale dhe vendqëndrimin e tij për periudhën e karantinës së nevojshme ose për vendosjen e kontaktit nga autoriteti kompetent. Pasi i ka dhënë plotësisht të gjitha informacionet e nevojshme, udhëtari merr si konfirmim një dokument në formatin PDF.

Kur udhëtari nuk ka qëndruar në asnjë zonë rreziku 10 ditët e fundit, procesi i regjistrimit përfundon më herët dhe nuk lëshohet asnjë konfirmim.

Të dhënat që mblidhen nga udhëtarët i transferohen automatikisht institucionit kompetent në bazë të vendqëndrimin të dhënë (zakonisht Zyrës së Shëndetit Publik) dhe vetëm ajo ka qasje në këto të dhëna. Të dhëna transmetohen të koduara, 14 ditë pas hyrjes të dhënat fshihen automatikisht.

### **Në cilin moment duhet të regjistrohem?**

Regjistrimin duhet ta bëni para se të niseni. Paraqitja e një dëshmie se e keni kryer me sukses regjistrimin digjital të hyrjes në Gjermani (ose se keni mbushur plotësisht një deklaratë zëvendësuese, si përjashtim) është kusht për transportin, kur hyni në Gjermani me avion, me anije, me tren ose me autobus.

## A ekziston detyrimi për regjistrim edhe për të miturit?

Të miturit përfshihen në detyrimin për regjistrim.

Të miturit që udhëtojnë me ju nuk duhet të regjistrohen vetë, por mund të deklarohen kur regjistrohet personi shoqëruar i rritur përgjegjës.

Megjithatë, kur të miturit udhëtojnë vetëm, ata duhet të plotësojnë formularin e tyre.

## Në rastet kur keni probleme teknike

### Çfarë të bëj kur nuk kam qasje në kompjuter ose në telefon celular inteligjent ose kur nuk është në dispozicion faqja e internetit e DEA (e regjistrimit digjital të hyrjes)?

Kur në raste të jashtëzakonshme (p.sh. për shkak të mungesës së pajisjeve teknike ose të ndonjë problemi teknik me faqen në internet) nuk keni mundësi të kryeni regjistrimin digjital të hyrjes në Gjermani, jeni të detyruar **të plotësoni në letër** një të ashtuquajtur **deklaratë zëvendësuese**. Formularin përkatës mund ta shkarkoni në faqen e internetit të Ministrisë Federale të Shëndetësisë në adresën

<https://www.bundesgesundheitsministerium.de/coronavirus-infos-reisende/merkblatt-dea.html>).

Deklarata zëvendësuese, e plotësuar në tërësi, i duhet dorëzuar:

- transportuesit, në rastin e hyrjes direkte në Gjermani nga zonat e rrezikut brenda Hapësirës së Shengenit<sup>1</sup>,
- Policisë Federale, në kuadër të kontrollit të hyrjes në Gjermani, në rastin e hyrjes direkte nga zonat e rrezikut jashtë Hapësirës së Shengenit,
- Policisë Federale, kur e kërkon në kuadër të zbatimit të detyrave të policisë kufitare, pavarësisht nga përdorimi i një transportuesi, me përjashtim të rastit kur deklarata i është dorëzuar më parë një transportuesi.

Në të gjitha rastet e tjera, ju lutemi dërgojeni deklaratën zëvendësuese, të plotësuar në tërësi, menjëherë pas hyrjes në Gjermani, në adresën e mëposhtme:

Deutsche E-POST Solutions GmbH

Aussteigekarte

69990 Mannheim

Deklarata juaj zëvendësuese do t'i përcillet autoritetit kompetent përkatës.

---

<sup>1</sup> Belgjika, Danimarka, Gjermania, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Austria, Polonia, Portugalia, Suedia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Republika Çeke, Hungaria si dhe Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra.

Për sigurimin (shkarkimin nga interneti dhe shtypjen) e deklaratës zëvendësuese janë përgjegjës vetë udhëtarët që hyjnë në Gjermani.

## Kontrollet

### **A mund të udhëtoj me të tjerë pa e bërë regjistrimin digjital të hyrjes në vend?**

Kur nuk përfshihen në përjashtimet e lartpërmendura, nuk është e lejuar që t'ju transportojnë pa përfunduar regjistrimin digjital të hyrjes në Gjermani. Kjo bazohet në rregulloren e hyrjes në Gjermani të koronavirusit (Gazeta Zyrtare e Qeverisë Federale, Pjesa e Përgjithshme, 13.01.2021). Sipas saj, sipërmarrjeve të transportit nuk u lejohet të transportojnë persona, të cilët nuk paraqesin dëshmi se e kanë bërë regjistrimin digjital të hyrjes në Gjermani ose nuk kanë plotësuar një deklaratë zëvendësuese e që nuk përfshihen në asnjërin nga përjashtimet e lartpërmendura.

Ju lutemi mbani parasysh: kur të dhënat që keni dhënë duken që janë të pasakta, formulari i hyrjes nuk konsiderohet i plotësuar siç duhet. Në këtë rast, kompanitë e transportit nuk lejohen t'ju transportojnë.

### **Kush e kontrollon a është bërë regjistrimi digjital i hyrjes në Gjermani?**

Transportuesit, me përjashtim të rastit kur janë pjesë e sistemit lokal të transportit publik, kanë detyrimin të kontrollojnë para transportit a mund të paraqesin personat që udhëtojnë një dëshmi të regjistrimit digjital me sukses për hyrjen në Gjermani (në rastin e kompanive hekurudhore dhe në transportin detar të distancave të shkurtra, verifikimi mund të kryhet edhe gjatë udhëtimit). Në këto kontrolle, të dhënat tuaja personale kontrollohen edhe për besueshmërinë. Kur duket qartë që të dhënat janë të pasakta, transportimi juaj nuk mund të kryhet.

Nëse po hyni në Gjermani nga një zonë rreziku jashtë Hapësirës Shengen<sup>2</sup> dëshminë e regjistrimit digjital të hyrjes duhet t'a paraqitni, kur ua kërkojnë, në kuadër të kontrollit të hyrjes në vend (zakonisht te Policia Federale).

Pavarësisht nga rrethana, nëse po udhëtoni apo jo me një transportues, është e mundur që në kuadër të kryerjes së detyrave të policisë kufitare, t'ju kërkohet nga autoriteti përgjegjës për kontrollin policor të qarkullimit ndërkuftar (zakonisht Policia Federale) të paraqisni dëshminë se keni kryer me sukses regjistrimin digjital të hyrjes në Gjermani. Kjo vlen, për shembull, për rastet e hyrjes në rrugë tokësore, në të cilat Policia Federale kryen kontrolle rastësore pranë kufirit.

---

<sup>2</sup> Hapësira Shengen: Belgjika, Danimarka, Gjermania, Estonia, Finlanda, Franca, Greqia, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Austria, Polonia, Portugalia, Suedia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Republika Çeke, Hungaria si dhe Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra.



## **Çfarë duhet të mbani parasysh kur hyni në Gjermani me automjet?**

Detyrimi për të bërë një regjistrim digjital të hyrjes në Gjermani vlen pavarësisht nga mjete i transportit që përdorni për të hyrë në vend, dhe në këtë kuadër edhe kur hyni në Gjermani me një automjet.

Autoriteti i ngarkuar me kontrollin policor të qarkullimit ndërkufitar (zakonisht Policia Federale) mund të kryejë në afërsi të kufirit kontrolle të rastësishme dhe të kërkojë paraqitjen e dëshmisë së regjistrimit.